

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-027/14

Prishtinë, 12 shkurt 2016

Në çështjen juridike të:

A.S.

Letanc

Podujevë

Pala ankuese

Kundër

1. D.R.

Mileve Divac 17

34000 Kožujevo

Kragujevc

Serbi

2. K.B.P. në Podujevë

Rruga Zahir Pajaziti

Podujevë

Përfaqësuesi: Drejtori J.S.

Palët përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës i përbërë nga gjyqtarët Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit, Rolandus Bruin dhe Krassimir Mazgalov, anëtarë, duke vendosur në lidhje me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KKPK) nr. KPCC/D/A/188/2013, të datës 13 shkurt 2013, (lënda e regjistruar në Agjencinë Kosovare të Pronës (në tekstin e mëtejme: AKP) me numrin nr. KPA24674), në tekstin e mëtejme gjithashtu: Vendimi i KKPK-së, pas shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më 12 shkurt 2016, mori këtë:

AKTGJYKIM

Hidhet poshtë si e paafatshme ankesa e A.S. kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/A/188/2013, të datës 13 shkurt 2013, lidhur me kërkesën nr. KPA24674.

Përmbledhje e çështjeve procedurale dhe faktike

1. Më 21 shkurt 2007, D.R. (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në ankesë 1), ka paraqitur kërkesë në AKP, ku kërkon vërtetimin e pronësisë dhe ri-posedim mbi ngastrën e tokës në Dumnicë të Poshtme, zona kadastrale Dumnicë e Poshtme, Komuna e Podujevës, numër 1882/3, me sipërfaqe prej 01.08.41 ha (në tekstin e mëtejme: prona e kërkuar). Ajo gjithashtu ka kërkuar kompensim për shfrytëzimin e pronës së kërkuar pa miratim. Ajo thekson se me vendimin e Komisionit Komunal për kryerjen e procedurës dhe vendosjen mbi kërkesën për kthimin e tokës, të datës 14 gusht 1993, prona e kërkuar, që ishte konfiskuar nga ai, i ishte kthyer gjyshit të saj.
2. Më 12 shtator 2007 dhe më 11 prill 2012 zyrtarët e AKP-së kishin shkuar në vendin ku pretendohet se ndodhet prona e kërkuar dhe kishte vendosur një shenjë që tregonte se prona ishte çështje lëndore e kërkesës dhe se palët e interesuara mund të paraqisnin përgjigjet e tyre brenda 30 ditëve. Herën e parë AKP kishte vërejtur se ngastra ishte e zënë nga Kooperativa Bujqësore P., e përfaqësuar nga J.S. , Drejtor i Kooperativës (në tekstin e mëtejme: pala përgjegjëse në ankesë 2), i cili kërkonte të drejtën ligjore ndërsa herën e dytë ishte e zënë nga J.S. dhe në shfrytëzim nga familja S.. Fotot e bëra të pronës së kërkuar tregojnë se prona është tokë e punueshme.
3. Më 25 tetor 2007, J.S. ka nënshkruar ‘Deklaratën e Palës përgjegjëse në kërkesë, ku kërkon të drejtën ligjore ndaj pronës së kërkuar. Më 6 nëntor 2008 ai ka dorëzuar ‘Formularin e përgjegjës në kërkesë’ ku thekson se prona e kërkuar është pronë e palës përgjegjëse në ankesë 2 por se prona e kërkuar kishte qenë tokë e babait dhe gjyshit të tij. Ai kërkon që prona e kërkuar t’i kthehet atij.
Më 25 tetor 2007 pala ankuese ka dorëzuar gjithashtu një përgjigje, të datës 25 shtator

2007, në AKP ku thekson se (një pjesë e) pronës së kërkuar kishte qenë tokë e babait dhe gjithit të tij. Ai kërkon kthimin e pronës së kërkuar dhe njohjen e pronësisë së tij.

4. KKPK vendosi në vendimin e KKPK-së për të hedhur poshtë kërkesën. Në arsyetim (paragrafët 11, 18-22 dhe 80 të Vendimit Grupor) KKPK ka konstatuar se pala përgjegjëse në ankesë 1 nuk e ka dëshmuar se kërkesa e saj përfshinë rrethana që drejtpërdrejtë ndërlidhen apo rezultojnë nga konflikti i viteve 1998-1999 prandaj KKPK-ja nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me këtë kërkesë. KKPK gjithashtu ka sqaruar se pala ankuese për të mbështetur kërkesën e saj ka dorëzuar vendimin e vitit 1993 të Komisionit për Kthimin e Tokës në Podujevë. Komisioni kishte njohur pronësinë e babait të palës ankuese mbi pronën e kërkuar por pala ankuese gjithashtu shprehimisht e kishte pranuar para AKP-së se bartësi i pretenduar i së drejtës pronësore asnjëherë nuk kishte hyrë në posedim të pronës së kërkuar në bazë të Vendimit të vitit 1993.
5. Vendimi i ishte dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë 2 më 15 gusht 2013 dhe palës ankuese më 5 shtator 2013. Sipas tabelës së njoftimit, të datës 24 shtator 2013, të quajtur “Njoftim mbi vendimet e KKPK-së të cilat nuk janë marrë”, pala përgjegjëse në ankesë 1 nuk kishte ardhur në terminin e caktuar më 16 gusht 2013, për të marrë Vendimin e KKPK-së.
6. Pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së më 6 dhjetor 2013. Ai kërkon miratimin e ankesës së tij dhe njohjen e tij si bartës të së drejtës pronësore mbi pronën e kërkuar.
7. Ankesa i ishte dorëzuar palës përgjegjëse në ankesë 2 më 11 shkurt 2014. Sipas një e-mail-i të datës 29 maj 2014 pala përgjegjëse në ankesë 1 kishte vizituar zyrën e Përfaqësuesit të AKP-së por kishte refuzuar të nënshkruante apo të pranonte ndonjë dokument. As pala përgjegjëse në ankesë 1 dhe as pala përgjegjëse në ankesë 2 nuk kishin marrë pjesë në procedurën ankimore para Gjykatës Supreme.
8. Gjykata Supreme i kishte dërguar një Urdhër Gjykate, të datës 20 tetor 2015, palës ankuese. Gjykata Supreme kishte kërkuar nga pala ankuese të sqaronte kush duhej të

ishite pala ankuese, pasi që me ankesën ishte dërguar një kopje e letërnjoftimit të M.S. dhe jo e A.S. dhe dosja e lëndës nuk përmban asnjë dokument identifikimi të A.S. . Gjithashtu, palës ankuese i jepet mundësia për të sqaruar përse ai nuk e ka dorëzuar ankesën brenda afatit 30 ditorë për paraqitjen e ankesës pas pranimit të Vendimit të KKKPK-së. Së treti atij i jepet mundësia të sqaroj mbi çfarë baze kërkesa e tij që të njihet si bartës i së drejtës pronësore do mund të miratohej, përderisa ai nuk kishte qenë paraqitësi fillestar i kërkesës në procedurën para KKKPK-së.

9. Pala ankuese në përgjigjen e tij në Urdhrin e Gjykatës, të datës 18 dhjetor 2015, thekson se ai, A.S. , është pala në këtë procedurë. Ai dorëzon një kopje të letërnjoftimit të tij. Ai gjithashtu thekson se ai nuk e ka paraqitur ankesën brenda afatit sepse ai kishte qenë shumë i sëmurë në atë kohë. Ai dorëzon dy raporte të Specialistit të Neurologjisë lidhur me të, nga doktorët B. Td.he B. Sh. njëri mban datën 2 qershor 2011 dhe tjetri 18 dhjetor 2015. Raporti i datës 18 dhjetor 2015 shkruan: ‘Pacienti vjen rregullisht në kontrollë sepse ka kokëdhëmbje, marramendje, mungesë të vullnetit për të jetuar, pagjumësi, është i palumtur dhe ka frikë. Ai është pacienti i rregullt që nga viti 2011 dhe ka përshkallëzime të përkohshme të sëmundjes.’

Pretendimet e palës ankuese

10. Pala ankuese kundërshton vendimin e KKKPK-së duke konsideruar se ai përmban gabime thelbësore apo mos-zbatim të së drejtës materiale ose procedurale dhe për shkak të vërtetimit të gabuar të vendimit dhe fakteve të pamfajtueshme.
11. Pala ankuese sqaron se bazuar në vendimin nr. 08-01/611, të lëshuar nga Drejtorati për Kadastër, Gjeodezi dhe Pronë i Komunës së Podujevës më 19 dhjetor 2012, prona e kërkuar është regjistruar në emër të “Ndermarrja e Re”, domethënë, Kooperativa Bujqësore “Slloga” Podujevë. Ai kërkon nga Gjykata Supreme të miratoj të drejtën e tij pronësore.

Arsyetimi ligjor

12. Ankesa është e paafatshme.

13. Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 për Zgjidhjen e Kërkesave që kanë të bëjnë me Pronën e Paluajtshme Private, përfshirë Pronë Bujqësore dhe Komerciale, e ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 (në tekstin e mëtejshëm: Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50) parasheh me sa vijon: *“Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës në lidhje me vendimin e Komisionit për kërkesën, pala mund të dorëzoj përmes Sekretarisë Ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës, në Gjykatën Supreme të Kosovës një ankesë kundër një vendimi të tillë”*.
14. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese të enjëtën më 5 shtator 2013. 30 ditë më vonë ishte e shtunë, 5 shtator 2013. Afati kohor për dorëzimin e ankesës rrjedhimisht kishte mbaruar të hënën, më 7 tetor 2013. Ankesa ishte dorëzuar nga pala ankuese më 6 dhjetor 2013. Kjo ishte bërë pas kalimit të afatit.
15. Pala ankuese nuk ka paraqitur arsye të justifikuar për këtë vonesë. Pretendimi se ai kishte qenë shumë i sëmurë në atë kohë nuk mjafton për një vendim tjetër, sepse nga raportet e dorëzuara nuk mund të konstatohet se ai gjatë intervalit kohor nga 5 shtatori 2013 deri më 7 tetor 2013 për shkak të arsyeve shëndetësore ishte në pamundësi të paraqeste ankesën apo që këtë ta bënte përfaqësuesi i tij.
16. Prandaj, në përputhje me nenin 13.3 (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 dhe nenin 195.1(a) dhe 196 të LPK-së, Gjykata Supreme vendos si në dispozitiv.

Këshillë ligjore

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 ky aktgjykim është i plotëfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i Kolegjit

Krassimir Mazgalov, Gjyqtar i EULEX-it

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it